



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 1/128

Datë: 11.06.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 qershor 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhja 126 dhe 127 e Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 2/128  
Datë: 11.06.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 qershor 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Plani i Veprimit për Partneritet Evropian për vitin 2010.
2. Buxheti për zbatimin e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian 2010 duhet të mbetet brenda ndarjeve Buxhetore të organizatave buxhetore për vitin 2010 dhe në pajtim me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2011-2013.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra e Kryeministrit, Ministria e Integritimit Evropian, Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe Institucionet tjera kompetente.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 3/128

Datë: 11.06.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 qershor 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për vitin 2011-2013.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që Kornizën nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedoj Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 4/128

Datë: 11.06.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 qershor 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 5/128

Datë: 11.06.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 qershor 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 6/128

Datë: 11.06.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 qershor 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 177 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 7/128

Datë: 11.06.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 qershor 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Projektligji për Ujërat e Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 8/128

Datë: 11.06.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 qershor 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Projektligji për Dhënie në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 9/128

Datë: 11.06.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L - 139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 qershor 2010, mori

**V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R**

1. Miratohet shpronësimi i pronave të paluajtshme private në ngastrat kadastrale të paraqitura në tabelat e mëposhtme të cilat janë pjesë e këtij vendimi të Autostradës Vërmicë - Merdare, segmenti Vërmicë - Novakë, Komuna e Prizrenit, përkatësisht zonat kadastrale Vërmicë, Zhur, Poslisht, Vlashnje, Prizren, Atmagjë, Dushanovë, Trepeticë, Petrova Sellë, Caprac, Shpenadi, Velezhë dhe Novakë.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Ministria për Ekonomi dhe Financa, Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit dhe Komuna e Prizrenit, i dërgojnë vendimin subjektit kërkuar dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Ministria për Ekonomi dhe Financa në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë e këtij vendimi është Akti i vlerësimit në të cilën është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilat janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit Ministria për Ekonomi dhe Financa të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të pronës së shpronësuar të përcaktuar me këtë vendim.

6. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejt dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura këtij vendimi.
7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria për Ekonomi dhe Financa, Ministria e Transportit dhe Postë-telekomunikacionit dhe Komuna e Prizrenit.
8. Vendimi Përfundimtar hyn fuqi ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Komunës së Prizrenit



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/128

Datë: 11.06.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 qershor 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Strategjia për Pronësi Intelektuale dhe Plani i Veprimit për vitin 2010-2014.
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe institucionet tjera për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/128


Datë: 11.06.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 qershor 2010, mori

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 530.000.00 (pesëqindetridhjetë mijë) euro për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga mosshfrytëzimi e tokës për periudhën 2001-2009, në fshatin Debëllde, Komuna e Vitisë.
2. Për fazën e parë ndahen 200,000.00 (dyqind mijë) euro nga shuma e caktuar në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezervat e Qeverisë, shpenzime të paparashikuara, kategoria rezervat dhe barten në kategorinë subvencione dhe transfere në Komunën e Vitisë.
4. Kuvendi Komunal i Vitisë themelon dhe autorizon komisionin komunal për ndarjen e mjeteve për kompensimin e dëmeve për secilin pronar, Komisioni kryen detyrat në pajtim me rekomandimet e Komisionit Ndërmintor për vlerësimin e dëmeve në pronat e pronarëve në fshatin Debëllde, Komuna e Vitisë për periudhën 2001-2009 dhe propozimin e masave adekuate, të themeluar me vendimin e Qeverisë Nr.02/89 të datës 23 tetor 2009.
5. Kuvendi Komunal i Vitisë i raporton me shkrim Qeverisë së Republikës së Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe Komuna e Vitisë.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 12/128

Datë: 11.06.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 qershor 2010, mori

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Lidhjes së Shkrimtarëve për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 6,000.00 (gjashtëmijë) euro për financimin e Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë "Drini Poetik".
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezervat e Qeverisë, shpenzime të paparashikuara, kategoria rezervat dhe barten në xhirrollogarinë e Lidhjes së Shkrimtarëve numër 1701001010330195 në bankën komerciale NLB Prishtina.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria për Ekonomi dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 13/128

Datë: 11.06.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 qershor 2010, mori

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Departamentit për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 50,000.00 (pesëdhjetë mijë) euro.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi transferohen nga buxheti i Komisionit Qeveritar për Persona të Pagjetur dhe barten në kodin buxhetor të Departamentit për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, gjatë rishikimit të buxhetit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria për Ekonomi dhe Financa, Ministria e Drejtësisë dhe Zyra e Kryeministrit.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAJI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë